

**AUTORITETI MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**BANKA BOTËRORE**

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

**QËNDRIMI I NDËRMARRJEVE  
PËR SKEMAT E PENSIONEVE PRIVATE  
NË SHQIPËRI**

**Analizë vrojtimi**

**Dhjetor 2015**

# PËRMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Rezultatet e dala nga analiza e pyetjeve të pyetësorit	5
2.1. Informacion i përgjithshëm për ndërmarrjen	5
2.1.1. <i>Struktura e popullatës së ndërmarrjeve të vrojtuar</i>	5
2.1.2. <i>Struktura e popullatës së ndërmarrjeve të vrojtuar, sipas intervaleve të pagesave</i>	9
2.1.3. <i>Niveli i njohurive mbi planet e pensionit</i>	11
2.1.4. <i>Oferta e planeve të pensionit</i>	12
2.2. Informacion mbi ndërmarrjet që nuk ofrojnë plane pensioni profesionale	13
2.2.1. <i>Interesi i vetë ndërmarrjes për planet e pensionit profesional</i>	14
2.2.2. <i>Interesi i punëmarrësve për planet profesionale të pensionit</i>	15
2.2.3. <i>Faktorët mbështetës apo pengues në ndërtimin e planeve të pensionit nga ana e ndërmarrjeve</i>	16
2.2.4. <i>Veprimi i SHAFP</i>	18
2.3. Oferta për plane pensioni ekzistuese	19
2.3.1. <i>Struktura e ndërmarrjeve të vrojtuar që ofrojnë plane pensioni</i>	19
2.3.2. <i>Tiparet e planeve të pensionit të ofruara</i>	19
2.4. Informacion përmbyllës	20
3. Përfundime	23
4. Referenca dhe burimet e informacionit	24
5. Shtojcat	
Shtojca 1: Pyetësori	25
Shtojca 2: Fazat dhe metodologjia e vrojtimit	35
Shtojca 3: Tabelat e vrojtimit	40

## Parathënie

Botimi “Qëndrimi i ndërmarrjeve për skemat e pensioneve private në Shqipëri” sjell tek ju rezultatet e vrojtimit dhe analizën e tyre, të kryer me ndërmarrjet private në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me këtë publikim Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) fillon serinë e publikimeve të analizave të vrojtimit. Vrojtimet përbëjnë për AMF-në një mjet të ri me anë të të cilit do të ndiqen zhvillimet në tregjet financiare, si dhe evoluimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të përdoruesve të produkteve të këtyre tregjeve. Ndërsa analiza e rezultateve të vrojtimit siguron për AMF-në informacionin e nevojshëm për ndërtimin e strategjive dhe planeve të veprimit. Pavarësisht rezultateve modeste të fillimit, ato konsiderohen të rëndësishme, sepse krijojnë bazën mbi të cilën AMF ka mundësi të matë efektin e politikave dhe të veprimeve.

Analiza e vrojtimit që merr sot në dorë lexuesi është kryer në funksion të nxitjes së zhvillimit të tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri. Publikimi përmban tre pjesë të rëndësishme:

- Analizën e rezultateve të vrojtimit, argumentimin e tyre, shoqëruar me disa rekomandime;
- Shtojcat metodologjike, të cilat mbështesin vlefshmërinë e rezultateve të vrojtimit;
- Bazën e të dhënave të vrojtimit, të cilat mbështesin vlefshmërinë e analizës së vrojtimit.

## 1. Hyrje

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB), ka ndërmarrë një projekt të rëndësishëm<sup>1</sup> në tregun e pensioneve private vullnetare, me titull “Mbikëqyrja e pensioneve dhe zgjerimi i mbulimit”, financuar nga *FIRST Initiative* dhe AMF. Ky projekt synon zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) 2013 dhe ka dy komponentë kryesorë:

- Ndërtimi i një metodologjie të mbikëqyrjes me bazë rreziku për tregun e pensioneve private vullnetare;
- Përmirësimi i të kuptuarit dhe rritja e rolit të punëdhënësve, si rrugë për zgjerimin e mbulimit të skemave private të pensionit, si dhe mbështetja e përpjekjeve të AMF-së për të nxitur punëdhënësit në krijimin e planeve të pensionit për punonjësit e tyre.

Zgjerimi i mbulimit është element kyç për suksesin e këtij projekti por dhe faktor bazë për qëndrueshmërinë dhe shëndetin financiar të këtij segmenti në periudhë afatgjatë. Gjithashtu, parakushtet që nevojiten për zgjerimin e mbulimit, ndihmojnë dhe në dizenjimin e sistemit të mbikëqyrjes me bazë rreziku.

Dy janë përparësitë fillestare në këtë drejtim: së pari, produkti që shitet të jetë i përshtatshëm për punëdhënësit dhe, së dyti, grumbullimi i të dhënave të përshtatshme që do të ndihmojnë më vonë në një fushatë efektive për përfshirjen e punëdhënësve dhe punonjësve në këto skema.

Në qershor 2015, AMF, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), ndërmori një vërtetim në terren, për të studiuar shkallëne njohurive dhe qëndrimeve të punëdhënësve dhe pjesërisht edhe të punëmarrësve kundrejt skemave të pensioneve profesionale private. Për të patur rezultate sa më të dobishme dhe të kuptimta për zgjerimin e tregut të pensioneve private, në vërtetim u synua të përfshiheshin ndërmarrjet që kanë të paktën 20 të punësuar. Ndërmarrje të kësaj madhësie krijojnë kushtet që plani i pensionit të jetë një mundësi reale për t'u marrë në konsideratë nga këto ndërmarrje. Për të patur një përfaqësim sa më të gjerë u përcaktua që ndërmarrjet do të përzgjidheshin nga i gjithë spektri i nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike, si dhe nga i gjithë territori i vendit. Një tjetër kriter i vendosur ishte ndarja sipas kapitalit të huaj dhe atij shqiptar, në mënyrë që të kuptohet nëse origjina e kapitalit ka ndikime në qasjen e përgjithshme ndaj këtyre skemave.

Në përzgjedhjen e ndërmarrjeve në këtë fazë u përjashtuan ndërmarrjet me kapital shtetëror, pasi interesi ishte tek kuptimi i qasjes së ndërmarrjeve private, ku vendimmarrja është e kushtëzuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë nga faktorë si klima ekonomike, kultura e përgjithshme, madhësia etj. Në këtë mënyrë krijohet një panoramë më e pastër për qasjen e punëdhënësve për pjesëmarrjen në këto skema, që nuk varen nga vendimmarrja shtetërore.

---

<sup>1</sup>[http://www.amf.gov.al/bashkepunimi\\_projekt.asp?id=8](http://www.amf.gov.al/bashkepunimi_projekt.asp?id=8).

## 2. Rezultatet e dala nga analiza e pyetjeve të pyetësorit

Pyetësori i përdorur për vrojtimin përbëhet gjithsej nga njëzetetë pyetje të grupuara në katër seksione (shih shtojca 1):

- **Seksioni A** – përmban pyetje që lidhen me marrjen e informacionit të përgjithshëm mbi ndërmarrjen, pjesë e vrojtimit dhe ofrimin ose jo nga ana e ndërmarrjes të planeve të pensionit të punëdhënësit<sup>2</sup>.
- **Seksioni B** – përmban pyetje që lidhen me marrjen e informacionit nga ato ndërmarrje që aktualisht nuk ofrojnë plane të pensionit të punëdhënësit.
- **Seksioni C** – përmban pyetje që lidhen me marrjen e informacionit nga ato ndërmarrje që aktualisht ofrojnë plane të pensionit të punëdhënësit.
- **Seksioni D** – përmban pyetje që lidhen me marrjen e informacionit të përgjithshëm të natyrës konkluduese.

Pyetësori nuk është formuluar për të marrë informacion sasior, por përqendrohet në gjurmimin e perceptimeve dhe vlerësimeve të faktorëve që mbështesin apo pengojnë ofrimin e planeve të pensionit të punëdhënësit. Gjithashtu, megjithëse në masë më të kufizuar, nëpërmjet pyetësorit synohet të merret informacion edhe mbi shkallën e interesit të punëmarrësve për të kontribuar në skema alternative pensionesh.

### 2.1. Informacion i përgjithshëm për ndërmarrjen.

Seksioni A i pyetësorit përmban shtatë pyetje me anë të të cilave kërkohet të merret informacion i përgjithshëm mbi strukturën e popullatës së ndërmarrjeve, sipas tipareve të caktuara që i interesojnë analizës, informacion mbi ofrimin ose të jo të planeve të pensionit të punëdhënësit, si dhe shkallën e njohurive nga ana e punëdhënëseve dhe punëmarrësve për skemat e pensionit profesionale dhe personale. Në këtë seksion informacioni jepet për 2,074 ndërmarrje, të cilat kanë një numër të punësuarish prej 174,903 ose 16.8% të numrit gjithsej të të punësuarve në vend për tremujorin e parë 2015.<sup>3</sup>

#### 2.1.1. Struktura e popullatës së ndërmarrjeve të vrojtuar

Tiparet për të cilat analizohet struktura e popullatës së ndërmarrjeve të vrojtuar janë:

- **Numri i punonjësve**, sipas të cilit është përcaktuar “madhësia e ndërmarrjes”. Ky numër përbën tiparin bazë mbi të cilin analizohet popullata e vrojtuar. Sikurse është sqaruar në hyrje dhe pjesën metodologjike (shih shtojca 2), popullata u përzgjedh për ndërmarrjet që kanë 20 të punësuar e lart.<sup>4</sup> Ndërmarrjet me një numër të konsiderueshëm punonjësish përbëjnë grupin ku duhet kushtuar vëmendje për t’i përfshirë në skemat e pensioneve në funksion të objektivit të zgjerimit të tregut të pensioneve private;
- **Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes**. Ky tipar përcakton aktivitetin kryesor ekonomik të ndërmarrjes dhe na formon një profil të shpërndarjes së ndërmarrjeve sipas natyrës së veprimtarisë së tyre.
- **Rajoni gjeografik**. Ky tipar është identifikuar mbi bazën e qarkut, sipas ndarjes së re territoriale. Ai përcakton rajonin e vendit në të cilin zhvillon aktivitetin ndërmarrja dhe na formon një profil të shpërndarjes gjeografike të ndërmarrjeve.

<sup>2</sup>Në të gjithë materialin termat “plan pensioni profesional” dhe “plan pensioni i punëdhënësit” përdoren me kuptim të njëjtë.

<sup>3</sup>[http://www.instat.gov.al/media/301891/anketa\\_tremujore\\_e\\_forcave\\_te\\_punes\\_tl\\_-\\_2015.pdf](http://www.instat.gov.al/media/301891/anketa_tremujore_e_forcave_te_punes_tl_-_2015.pdf).

<sup>4</sup>Duhet pasur parasysh që popullata e përzgjedhur për vrojtim ka përfshirë kategori të caktuara ndërmarrjesh. Për rrjedhojë, numri i planeve të pensionit që analizohen në këtë vrojtim është më i ulët.

- **Pronësia e ndërmarrjes.** Ky tipar tregon pronësinë e ndërmarrjes sipas origjinës së kapitalit të saj, të huaj apo vendas.
- **Viti i krijimit të ndërmarrjes.** Ky tipar tregon “moshën” e ndërmarrjes si një tregues i përfaqësues i maturimit të saj në treg apo në ekonomi dhe na formon një profil të shpërndarjes së ndërmarrjeve në kohë.

Në materialin në vijim nëngrupimet për analizën e rezultateve formohen mbi bazën e këtyre tipareve. Nëpërmjet analizimit të rezultateve të vërtetimit bazuar në këto tipare të strukturës së popullatës së ndërmarrjeve të vërtetuara, merren informacione të dobishme që shërbejnë për hartimin e strategjive të përshtatshme për zgjerimin e tregut të pensioneve private. Për rrjedhojë, rezultatet shërbejnë si lëndë e parë si për strategjitë e autoriteteve politikëbërëse, në radhë të parë AMF-së, ashtu edhe për strategjitë e marketingut të shoqërive administruese të fondeve të pensioneve.


Analiza e informacionit mbi popullatën e ndërmarrjeve të vërtetuara detajohet më tej nëpërmjet kombinimit të tipareve të ndryshme të strukturës së saj. Si kriter për dhënie të informacionit për kombinimin e tipareve është vendosur pesha prej 10%. Çdo tipar i pranishëm nën këtë prag nuk identifikohet. Përqindjet llogariten mbi totalin e tiparit bazë sipas të cilit bëhet kombinimi dhe jo mbi totalin e ndërmarrjeve.

Gjithashtu, informacioni i përfshirë nga kombinimet jepet kur ka vlerë të shtuar për qëllime të analizës. Me këtë nënkuptohet që struktura e kombinimeve ka shmangie të konsiderueshme nga struktura bazë e popullatës së vërtetuar dhe, për rrjedhojë, formon informacion të dobishëm që mund të përdoret në procesin e politikëbërjes.

Ndërmarrjet, sipas kriterit të **madhësisë**, të përcaktuar me numrin e punonjësve të punësuar, konsiderohen si të mesme. Më tepër se gjysma e tyre (56%) kanë punësuar më pak se 50 vetë. Ndërmarrjet shumë të mëdha, me të punësuar mbi 250 vetë, përbëjnë vetëm 6% të ndërmarrjeve të vërtetuara (shih grafikun1).


Pra, në tërësi mund të themi se popullata e ndërmarrjeve të vërtetuara është e përqendruar drejt kufirit të poshtëm të madhësisë.

**Grafik 1: Struktura e ndërmarrjeve të vërtetuara sipas madhësisë (në % ndaj numrit gjithsej të ndërmarrjeve)**



Nga *kombinimi i madhësisë me origjinën e kapitalit* vërehet se struktura e ndërmarrjeve sipas kriterit të madhësisë është relativisht e qëndrueshme në ndërmarrjet me kapital shqiptar. Ndërsa në ato me kapital të huaj duket se shtohet pesha e ndërmarrjeve që mund të klasifikohen të mëdha dhe shumë të mëdha (shih grafikun 2).

**Grafik 2: Struktura e ndërmarrjeve të vrojuara sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit (në % ndaj numrit të ndërmarrjeve sipas tiparit të madhësisë)**



*Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjeve*, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NVE Rev. 2 (INSTAT), klasifikohet në 9 kategori (shih tabela 1):


**Tabela 1: Kategoritë e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve**

Simboli	Aktiviteti ekonomik
A.	Bujqësi, pyje, peshkim
B.	Industri nxjerrëse
C.	Industri përpunuese
D.	Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar
E.	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F.	Ndërtim
G.	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave dhe motocikletave
H.	Transporti dhe magazinimi
I.	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit
J.	Informacioni dhe komunikacioni
K.	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit
L.	Pasuritë e patundshme
M.	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike
N.	Shërbime administrative dhe mbështetëse
O.	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyrueshëm
P.	Arsimi
Q.	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale
R.	Arti, argëtimi dhe zbavitja
S.	Aktivitete të tjera shërbimi
T.	Shërbime në shtëpi
U.	Aktivitete të organizatave ndërkombëtare

Burimi: INSTAT


Ndërmarrjet e vrojuara janë të përqendruara më së shumti në tre aktivitete: industri përpunuese (28.9%); ndërtim (16.6%) dhe tregti (15.8). Relativisht i rëndësishëm konsiderohet edhe grupi i ndërmarrjeve që merren me shërbime administrative dhe mbështetëse (9.5%); ndërsa pjesa tjetër përfaqësohet me peshë relativisht të ulët, nga 0.2% deri në 4.2% (shih grafikun 3).

**Grafik 3: Struktura e ndërmarrjeve të vrojtura sipas aktivitetit ekonomik (në % ndaj numrit gjithsej të ndërmarrjeve)**



Sipas tiparit të ushtrimit të veprimtarisë së ndërmarrjes *në territorin gjeografik*, më shumë se gjysma e tyre, 52.2%, vepron në qarkun e Tiranës. Rajone të tjera relativisht të rëndësishme rezultojnë: Durrësi me 12.4%, Fieri dhe Shkodra me 7.9% dhe 7.1% përkatësisht. Pra, vetëm në zonën Tiranë-Durrës veprojnë 64.6% e ndërmarrjeve (shih grafikun 4).

**Grafik 4: Struktura e ndërmarrjeve të vrojtura sipas territorit gjeografik në të cilin ushtron aktivitetin (në % ndaj numrit gjithsej të ndërmarrjeve)**




Në popullatën e ndërmarrjeve të vrojtura, sipas *originës së kapitalit* mbizotërojnë me 85.2% ndërmarrjet shqiptare (mbi 50% e kapitalit të tyre ka origjinë vendase). Pjesa tjetër, 14.8% janë ndërmarrje që mbi 50% e kapitalit të tyre ka origjinë të huaj.

Në vite *krijimi* i ndërmarrjeve ka ardhur duke u rritur, por është përqendruar në periudhën 2001-2010, dekadë gjatë së cilës janë krijuar pothuaj gjysma e tyre (shih grafikun 5).



**Grafik 5: Struktura e ndërmarrjeve të vrojtuar sipas periudhës kohore të krijimit të tyre (në % ndaj numrit gjithsej të ndërmarrjeve)**




Një rezultat i tillë është i pritshëm duke patur parasysh që ekonomia shqiptare kaloi në ekonominë e tregut në vitin 1991. Gjithsesi, ndërtimi i një tregu funksional që vepron bazuar në ligjet përkatëse dhe mbikëqyret e rregullohet nga institucionet publike kërkon kohë. Po kështu, nevojitet kohë që legjislacioni dhe institucionet rregullatore të tregut të formojnë klimën e përshtatshme për biznes. Për këto arsye, krijimi i ndërmarrjeve rezulton të jetë i përqendruar pas viteve 2000. Ky element përforcohet edhe nga prirja për rritje të numrit të ndërmarrjeve të krijuara me kapital të huaj, të cilat si rregull tërhiqen nga qëndrueshmëria e mjedisit të biznesit.

#### **2.1.2. Struktura e popullatës së ndërmarrjeve të vrojtuar, sipas intervaleve të pagesave**

Në popullatën e ndërmarrjeve të vrojtuar, shumica e punëmarrësve, 63.5%, paguhen në intervalin 0-35 mijë lekë në muaj; 21.6% e punëmarrësve paguan në intervalin 35-65 mijë lekë dhe pjesa tjetër kanë paga më të larta se 65 mijë lekë (shih grafikun 6).


**Grafik 6: Struktura e punëmarrësve sipas intervaleve të pagesave nga punëdhënësit (në % ndaj numrit të punëmarrësve gjithsej në ndërmarrjet e vrojtuar)**




Nëse nisemi nga numri i ndërmarrjeve vërejmë se pjesa më e madhe e tyre, 60.1% ofrojnë pagesa në të tri intervalet e studiuara; janë 21 (1%) ndërmarrje që paguajnë punonjësit e tyre mbi 35 mijë lekë (intervalet 35-65 mijë lekë dhe mbi 65 mijë lekë), veçmas ose të kombinuar; 32.9% e ndërmarrjeve paguajnë veçmas ose të kombinuar në intervalet e poshtme, pra nën 65 mijë lekë dhe 6% e ndërmarrjeve kanë pagesa në dy intervalet skajore.

Nga kombinimi i *intervaleve të pagesave me aktivitetin ekonomik* vërehet se strukturat e intervaleve të pagesave për punëmarrësit në ndërmarrjet e vrojtura jo gjithmonë ndjekin strukturën e përgjithshme. Në intervalin më të ulët të pagesave janë të përqendruara më shumë ato ndërmarrje që ushtrojnë aktivitetet “bujqësi, pyje, peshkim”, “industria përpunuese” dhe “furnizimi me ujë, etj.”. Në intervalin më të lartë të pagesave janë të përqendruara më shumë ato ndërmarrje që ushtrojnë aktivitetet në “industri nxjerrëse”, “aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike”, “aktivitetet financiare dhe të sigurimit”, “informacioni dhe komunikacioni”. Ndërsa në intervalin e mesëm janë të përqendruara më shumë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetin e “energjisë elektrike, furnizimit me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar” (shih grafikun 7).

**Grafik 7: Shpërndarja e numrit të punëmarrësve në ndërmarrjet e vrojtura sipas intervalit të pagesës (në % ndaj numrit të ndërmarrjeve sipas tiparit të aktivitetit ekonomik)**





### 2.1.3. Niveli i njohurive mbi planet e pensionit

Në procesin e vrojtimit është kërkuar të përcaktohet shkalla e njohurive (nëpërmjet vetëvlerësimit apo vetëpërcaktimit) për planet e pensionit profesional dhe personal, si nga pikëpamja e punëdhënësit ashtu edhe e punëmarrësit. Të anketuarit ishin në gjendje ta jepnin këtë vlerësim edhe për punëmarrësit, pasi pyetësi është dërguar më parë pranë ndërmarrjes, duke lënë një periudhë kohe për të grumbulluar vlerësimin e punëmarrësve (shih shtojca 2).

Nga rezultatet e vrojtimit vërehet se ka një shkallë të konsiderueshme të mungesës së njohurive si nga punëdhënësit (rreth 1/3) ashtu edhe nga punëmarrësit (pothuaj gjysma). Është e pritshme që mungesa e njohurive të jetë më e theksuar tek punëmarrësit, pasi ata janë më pak të ekspozuar ndaj legjislacionit krahasuar me punëdhënësin dhe në kushtet kur nuk ka peshë organizimi dhe veprimtaria e sindikatave.


Edhe pjesa që shprehet se ka njohuri, përgjithësisht është e përqendruar në nivelin e njohurive më pak sesa niveli mesatar, dukuri e cila përsëri është më e theksuar ndër punëmarrësit krahasuar me punëdhënësit.

Duke e shprehur këtë rezultat me anë të një indeksi njohurish, që i merr vlerat nga 0, e cila i korrespondon kategorisë “nuk kam njohuri”, deri në 4, e cilai korrespondon kategorisë “kam njohuri shumë të mira”, vërejmë që shkalla e njohurive për të dyja kategoritë është nën nivelin mesatar prej 2, por më e lartë ndërmjet punëdhënësve krahasuar me punëmarrësit (shih tabelën 2 dhe grafikun 8).

**Tabela 2: Indeksi i njohurive për planet e pensionit në çdo kategori.**

Kategoria e njohurive	Vlera e indeksit
Nga punëdhënësi për planin e pensionit profesional	1.64
Nga punëmarrësi për planin e pensionit profesional	0.91
Nga punëdhënësi për planin e pensionit personal	1.60
Nga punëmarrësi për planin e pensionit personal	0.91

**Grafik 8: Shpërndarja e nivelit të njohurive mbi planet e pensione nga punëdhënës e punëmarrës (në % ndaj ndërmarrjeve gjithsej të vrojtuar)**




#### 2.1.4. Oferta e planeve të pensionit

Nga popullata e ndërmarrjeve të vrojtuar shumë pak prej tyre ofrojnë plane pensioni (22 ndërmarrje ose 1.06%), kundrejt 98.94% që nuk ofrojnë plane të tilla. Ky rezultat është i pritshëm po të kemi parasysh se sa i kufizuar ka qenë në vite tregu i pensioneve private në raport me tregun financiar.

**Kombinimi i origjinës së kapitalit me ofertën e planeve të pensionit** tregon se grupi i ndërmarrjeve që nuk ofrojnë plane pensioni ruan strukturën e popullatës së vrojtuar. Pra, shumica (85.9%) e ndërmarrjeve që nuk ofrojnë plane pensioni janë shqiptare. Kjo strukturë ndryshon në grupin e ndërmarrjeve që ofrojnë plane pensioni, sepse 18 nga 22 (ose 81.8%) ndërmarrjet që kanë një ofertë të tillë janë ndërmarrjet e huaja. Ky rezultat mbështet argumentin e përdorur në seksionin I.3. ku evidentohet se kultura e punëdhënësve, apo tradita e të bërit biznes është e tillë që ka frenuar zgjerimin e tregut të pensioneve private. Është e kuptueshme që ky tipar është i theksuar ndër ndërmarrjet me kapital shqiptar. Gjithsesi duhet theksuar se në të dy grupet e ndërmarrjeve oferta e planeve të pensionit mbetet shumë e kufizuar, me 5.9% e ndërmarrjeve të huaja dhe vetëm 0.2% e ndërmarrjeve shqiptare (shih grafikun 9).

**Grafik 9: Struktura e ndërmarrjeve që ofrojnë plane pensioni sipas origjinës së kapitalit (në % ndaj ndërmarrjeve sipas ofertës së planit të pensioneve)**



Grupi i ndërmarrjeve që ofrojnë plane pensioni është i përqendruar në dy aktivitete ekonomike: në aktivitetet administrative e mbështetëse dhe në ato financiare dhe të sigurimeve, dy degë ku ushtrojnë veprimtarinë ndërmarrje të huaja, një pjesë e të cilave janë në përbërje të grupeve ndërkombëtare. Këto ndërmarrje janë të përqendruara në qarkun e Tiranës dhe konsiderohen të mëdha pasi kanë një numër punonjësish që i përket intervalit 50-249 vetë.

Ndërsa grupi i ndërmarrjeve që nuk ofrojnë plane pensioni është i përhapur në të gjithë sektorët e ekonomisë, qarqet dhe me madhësi të ndryshme, duke ndjekur strukturën e ndërmarrjeve sipas këtyre tipareve.

\* \*  
\*

Në përfundim, nga analiza e informacionit të përgjithshëm për ndërmarrjet e vrojtura mund të themi se ekziston një terren pothuaj i zbrazët përse i përket ofrimit të planeve të pensionit nga ana e punëdhënësve. Gjithashtu, shkalla e njohurive mbi këto plane si nga punëdhënësit dhe nga punëmarrësit është më e ulët sesa niveli mesatar.

Për rrjedhojë, organizimi i çdo lloj fushate që zgjon interesin e punëdhënësve dhe punëmarrësve për plane pensioni dhe për të rritur njohuritë e tyre në këtë drejtim rezulton i dobishëm.

Në varësi të tipareve të ndërmarrjeve të vrojtura, kjo fushatë mund të synojë fillimisht qarkun e Tiranës, ose pak më gjerë rajonin Tiranë-Durrës, që konsiderohen si rajone me peshën kryesore dhe më të qëndrueshme në veprimtarinë ekonomike apo që punësojnë numrin më të madh të punonjësve.


## 2.2. Informacion mbi ndërmarrjet që nuk ofrojnë plane pensioni profesionale

Seksioni B i pyetësorit përmban tetë pyetje, me anë të të cilave kërkohet të merret informacion mbi arsyet kryesore se përse këto ndërmarrje nuk kanë plane pensioni, profili i ndërmarrjeve që nuk kanë këto plane, si dhe për të kuptuar faktorët që i kanë frenuar ato për të tilla oferta apo dhe për të kuptuar prirjen për të ardhmen. Në total ndërmarrjet që i përkasin këtij grupi janë 2 052, pra të gjitha ndërmarrjet që nuk ofrojnë plane profesionale pensioni dhe që përbëjnë 98.9% të ndërmarrjeve gjithsej të vrojtura.

### 2.2.1. Interesi i vetë ndërmarrjes për planet e pensionit profesional

Nga ky grup ndërmarrjesh, vetëm 14% e tyre kanë menduar të ndërtojnë një plan pensioni profesional. Këto ndërmarrje që kanë shfaqur më tepër interes janë të përqendruara në “aktivitetet financiare dhe të sigurimit”, “shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale”, si dhe aktivitetin “bujqësi, pyjet, peshkimi”, përkatësisht në 41%, 32% dhe 31% të rasteve (shih grafikun 10).

**Grafik 10: Frekuenca e ndërmarrjeve që kanë menduar të ofrojnë plane pensioni sipas aktivitetit ekonomik (në % ndaj ndërmarrjeve që nuk ofrojnë plan pensioni)**




Grupi i ndërmarrjeve që e kanë menduar ofrimin e planeve të pensionit kryesohet natyrshëm nga aktivitetet financiare dhe të sigurimeve, bazuar dhe në faktin se ato kanë shkallë më të lartë të kuptuarit të produkteve financiare sesa aktivitetet e tjera. Ky rezultat ndjek dhe prirjen e ndërmarrjeve që kanë plane pensioni dhe njëkohësisht përforcon konkluzionin e seksionit 2.1, se ndërmarrjet që bëjnë pjesë në grupet e huaja, që kanë më shumë se 250 të punësuar, kanë më tepër prirje të ofrojnë plane pensioni. Konkretisht, tendenca për të ofruar plane pensioni u vrojtua në 25% të rasteve në ndërmarrjet që kanë më tepër se 250 të punësuar dhe aty ku mbizotëron kapitali i huaj një gjë e tillë u vrojtua në 28% të rasteve.

Megjithatë, këto ndërmarrje nuk kanë konkretizuar një mendim të tillë nën ndikimin e një grupi faktorësh, ku ndër më të rëndësishmit kanë qenë: “pamjaftueshmëria e lehtësive fiskale”<sup>5</sup> (46%), “kanë marrë përparësi të tjera përfitime ofruar punonjësve” (43%); apo “krijimi i një plani pensioni konsiderohet për punëdhënësin si shumë i kushtueshëm” (36%). Ndërkohë, grupi i dytë i rëndësishëm i faktorëve, pas faktorit të koston, është besimi në sistemin financiar dhe në institucionet e tregut të pensioneve (shih grafikun 11).

<sup>5</sup>Vrojtimi ka qenë për gjendjen në 2014, duke mos marrë parasysh korrigjimin e trajtimit fiskal të fondeve.

**Grafik 11: Renditja e faktorëve që kanë mbështetur krijimin e planeve të pensionit, sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur faktorin**



Në 21 sektorë të anketuar, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike, ku faktori frenues kanë qenë lehtësitë fiskale, 82% e rezultatit përbëhet vetëm nga ndërmarrjet që veprojnë në pesë sektorë, përkatësisht: tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave dhe motoçikletave, ndërtim, industri përpunuese, shërbime administrative dhe mbështetëse, si dhe industri nxjerrëse.

Në pjesën më të madhe të këtyre sektorëve është vërejtur dhe faktori “kanë marrë përparësi të tjera përfitime ofruar punonjësve” dhe “krijimi i një plani pensioni konsiderohet për punëdhënësin si shumë i kushtueshëm”. Të tre faktorët mbizotërues, që kanë frenuar krijimin e planeve të pensionit, janë vërejtur me shpeshësi më të lartë në ndërmarrjet me kapital shqiptar, të cilat kanë numër të punësuarish nën 50 vetë.

### 2.2.2. Interesi i punëmarrësve për planet profesionale të pensionit

Në grupin e ndërmarrjeve që nuk ofrojnë plan pensioni u kërkua informacion nëse ka patur nismë apo kërkesë nga ana e punëmarrësve që ndërmarrja të ndërtojë një plan pensioni. Vërehet që edhe vetë punëmarrësit shfaqin interes të pakët për të tilla skema. Nga punonjësit është kërkuar që të merret në shqyrtim mundësia për ndërtimin e një plani pensioni vetëm në 19 ndërmarrje, që përbëjnë 0.93% e ndërmarrjeve që nuk ofrojnë plan pensioni shih grafikun 12).

**Grafik 12: Shpërndarja e ndërmarrjeve ku është shfaqur interes nga punëmarrësit që të ndërtojnë plane pensioni, sipas aktivitetit ekonomik**




Duke parë kërkesën relativisht të dobët që dhe vetë punonjësit kanë për të tilla plane, është kërkuar perceptimi që kanë ndërmarrjet për mënyrat më efikase për të bindur punonjësit. Sipas perceptimit, faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e interesit është informimi i punëmarrësve, kryesisht me materiale të shkruara, por edhe me prezantime për mënyrat se si funksionojnë dhe përfitimet që mund të kenë ata nga forma të tilla kursimi.

Ky proces informimi përforcohet me faktorin e tretë ndikues që është ndërgjegjësimi (pra informimi) mbi pamjaftueshmërinë e pensionit shtetëror për të përmbushur nevojat për të ardhura kur të arrijnë moshën e pensionit.

Në grupin e dytë të rëndësishëm të faktorëve është edhe përmirësimi i besimit në shoqëritë e adiministrimit të fondeve të pensionit (SHFAP) dhe në tërësi në sistemin financiar (shih grafikun 13).

Ky rezultat tregon për nevojën e organizimit të fushatave të marketingut dhe të ndërgjegjësimit që të jenë më proaktive nga ana e SHAFP-së, duke përdorur informacionin e shkruar dhe forma prezantimi të drejtpërdrejta me punëmarrësit, formë kjo e përzgjedhur nga afro 72% e ndërmarrjeve të anketuara.

**Grafik 13: Renditja e faktorëve që ndërmarrjet mendojnë se mund të nxitet kërkesa e punonjësve për plane pensioni, sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur faktorin**




### 2.2.3. Faktorët mbështetës apo pengues në ndërtimin e planeve të pensionit nga ana e ndërmarrjeve

Në tërësi është e dukshme që një grup shumë i vogël ndërmarrjesh kanë plane pensioni ose kanë interes për të tilla plane. Arsyet për një situatë të tillë i zbulojmë nga perceptimet që kanë vetë ndërmarrjet në lidhje me faktorët që mbështesin apo pengojnë në ndërtimin e planeve të pensionit.

**Faktorë mbështetës.** Vërehet që faktorët të cilët mund të mbështesin ndërtimin e planit të pensionit, pra që një ndërmarrje ka nevojë t'i marrë parasysh, ndikojnë pothuaj në masë të njëjtë dhe ato lidhen me nevojën për qëndrueshmëri të forcës së punës (rritja e shkallës së besnikërisë së punonjësve ndaj ndërmarrjes, dhënie mesazhi për punonjësit se ndërmarrja ka një angazhim afatgjatë për ta, si dhe nxitja e kursimeve nga ana e punonjësve). Më pak i konsiderueshëm, por gjithsesi i rëndësishëm është faktori që lidhet me koston, pra përfitimi i lehtësive tatimore (shih grafikun 14).




**Grafik 14: Renditja e faktorëve mbështetës për ndërmarrjet për të ndërtuar plane pensioni, sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur faktorin**




**Faktorë pengues.** Në lidhje me faktorët pengues për ndërtimin e planit të pensionit vërejmë përsëri se dallon një faktor i rëndësishëm që plani konsiderohet si shumë i kushtueshëm për t'u ndërtuar dhe i lidhur me të edhe fakti që nuk konsiderohet se sjell përfitim për ndërmarrjen (pra, qartazi perceptohen si ndikues faktorët e kostos). Në masë gati të njëjtë, por më pak të rëndësishëm janë faktorët që vetë punonjësit nuk duan skema të tilla dhe se përfitojnë nga të tjera forma. Grupi i tretë i faktorëve janë ata që lidhen me besimin në institucionet financiare që ofrojnë dhe mbikëqyrin të tilla produkte (shih grafikun 15).

**Grafik 15: Rëndësia e faktorëve pengues për ndërmarrjet për të ndërtuar plane pensioni, sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur faktorin**



Që ndërmarrjet të shtojnë interesin për të nisur një plan pensioni për punonjësit e vet, sipas perceptimit të tyre, faktorët që ndikojnë më së shumti janë rritja e nivelit të të kuptuarit të funksionimit dhe përfitimit të skemave (pra informimi), pasuar nga kërkesa nga vetë punonjësit dhe përmirësimi i lehtësive tatimore. Grupi i dytë lidhet me besimin në sistemin financiar dhe më pak ndikojnë faktorët e konkurrencës apo shqetësimet e punonjësve për të ardhmen (shih grafikun 16).

**Grafik 16: Renditja e faktorëve që nxisin interesin e ndërmarrjeve për të ndërtuar plane pensioni, sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur faktorin**



#### 2.2.4. Veprimi i SHAFP-së

Për të shqyrtuar arsyet e zgjerimit të kufizuar të tregut të pensioneve private, çështja është trajtuar jo vetëm nga ana e kërkesës (punëdhënës dhe punëmarrës) por edhe nga ana e ofertës (shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve).

Vërehet që edhe oferta ka qenë relativisht e kufizuar. Kështu, vetëm 14.1% e ndërmarrjeve të vrojuara janë kontaktuar ndonjëherë nga një SHAFP, pjesa tjetër 85.9% nuk kanë patur kontakt. Ndër SHAFP-të e licencuara dhe që veprojnë në treg në Shqipëri, më tepër kontakte janë realizuar nga Sigal UNIQA Group austria sh.a. (45.1% e rasteve) pasuar nga SiCRED (39.9%) dhe më pas nga Raiffeisen me vetëm 15% të rasteve. Ky rezultat është i pritshëm po të kemi parasysh ritmet e zgjerimit të secilit fond në treg gjatë periudhës 2011- qershor 2015. Pra, pjesëmarrja në treg është drejtpërdrejt rezultat i strategjisë së ndjekur nga ana e shoqërive.

\*                      \*

\*

Në përfundim, nga analiza e faktorëve që kanë penguar ndërmarrjet për krijimin e planeve të pensionit, mund të themi se ishte e pritshme që mungesa e zbatimit të lehtësirave fiskale, do të luante rolin kryesor, pasi praktikisht e bën të pamundur promovimin e produktit. Me zgjidhjen e këtij ngërçi në paketën fiskale të 2015, situata është korrigjuar, kështu që mund të ndryshojë pozitivisht.

Një tjetër grup faktorësh pengues që duhen kapërcyer është mungesa e besimit në sistemin financiar në tërësi, gjë që arrihet në sajë të një procesi të gjatë rregullimi efikas dhe ndërtimi të një historiku pozitiv në ofrimin e një produkti cilësor pensioni nga operatorët e tregut. Rreziku i reputacionit në këtë segment, në tërësi, vlerësohet i lartë pasi kemi të bëjmë me një marrëdhënie besimi afatgjatë, e cila kërkon etikë të lartë profesionale nga operatorët e tregut, si dhe në vazhdimësi një mbikëqyrje efektive dhe të orientuar sipas administrimit të rrezikut.

Shkalla e ulët e njohurive, e vërejtur më tepër në bizneset me kapital vendas është një pengesë që duhet kapërcyer me dhënien e informacioneve të shkruara dhe shtimin e kontakteve të drejtpërdrejta, prezantimeve apo fushatave të ndërgjegjësimit për përfitimet nga këto skema. Këta elementë duhet të jenë në thelb të veprimeve apo strategjive të marketingut të SHAFP-së për rritjen e zgjerimit të këtij tregu.

Zgjerimi i skemave të pensioneve në periudhën afatgjatë do të ulte ndjeshëm dhe kostot e ofrimit të produktit, duke ndikuar në qëndrueshmërinë e këtij segmenti të tregut financiar.

### **2.3. Oferta për planet e pensionit ekzistuese**

Seksioni C i pyetësorit përmban nëntë pyetje me anë të të cilave kërkohet të merret informacion mbi disa tipare të planeve të pensionit që u ofron punëdhënësi punëmarrësve, për ato raste të ndërmarrjeve të vrojtura që deklarojnë se kanë plane të tilla. Në këtë seksion informacioni jepet për 22 ndërmarrje që ofrojnë plane pensioni, të cilat kanë 2,303 të punësuar ose 1.3% të të punësuarve gjithsej në popullatën e ndërmarrjeve të vrojtura.

#### **2.3.1. Struktura e ndërmarrjeve të vrojtura që ofrojnë plane pensioni**

Analiza e strukturës së ndërmarrjeve të vrojtura që ofrojnë plane pensioni sipas tipareve të strukturës është e kufizuar për shkak të numrit të vogël të elementëve në këtë nënpopullatë. Për rrjedhojë, përfundimet në këtë seksion duhet të merren me rezervë dhe mund të mos përfaqësojnë domosdoshmërisht prirje që mund të vërehen edhe në të ardhmen.

Nga vrojtimi u synua të merrej informacion mbi kohën kur ndërmarrjet kanë filluar të ofrojnë plane pensioni. Ato kanë filluar të ofrojnë këto plane nga viti 2011 e në vijim. Madje dhe ato ndërmarrje që e kanë planin e pensionit pjesë të paketës para vitit 2011 kanë filluar ta aplikojnë në vitin 2011.

Të gjitha ndërmarrjet që ofrojnë plane pensioni e ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun e Tiranës, kryesisht të natyrës së shërbimeve administrative dhe mbështetëse (16) dhe financiare e të sigurimit (6). Shumica e ndërmarrjeve që ofrojnë plane pensione janë me kapital të huaj. Të gjitha këto ndërmarrje i përkasin grupit të ndërmarrjeve me të punësuar ndërmjet 50-249 vetë.

#### **2.3.2. Tiparet e planeve të pensionit të ofruara**


Megjithëse numri i ndërmarrjeve që ofrojnë plane pensioni është i vogël, edhe më e papërfillshme bëhet kjo ofertë, duke patur parasysh që 14 ndërmarrje nuk ua ofrojnë planet e pensionit të gjithë punonjësve të tyre, kundrejt 8 ndërmarrjeve që ofrojnë për të gjithë punonjësit me kohë të pacaktuar. Këto plane pensioni ofrohen të gjitha sipas legjislacionit në fuqi, me administrim nga SHAFP-të.

Përsa i takon kontributeve në të gjitha rastet ai ofrohet në raportin 1 me 1 ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit. Në 20 ndërmarrje punëmarrësi mund të zgjedhë të kontribuojë edhe më tepër, pa përfituar kontribut shtesë nga punëdhënësi.

Këto kontribute në 14 ndërmarrje përcaktohen si përqindje ndaj pagës bruto, ndërsa në 8 ndërmarrje si shumë fikse bazuar në intervalet e pagave që ka ndërmarrja. Kontributet e përcaktuara si përqindje ndaj pagës bruto (në 14 ndërmarrje) janë në intervalin 2-4% të saj (përfshirë edhe 4). Për grupin e ndërmarrjeve që përdorin shumica fikse, 6 prej tyre kanë kontribute që kapërcejnë në intervalin 4-6% (pa përfshirë 4) dhe në 2 ndërmarrje kontributet janë në modeste, pra më pak se 2%. Këto rezultate pasqyrojnë ose përforcojnë shqetësimin e perceptuar se skema të tilla janë të kushtueshme për ndërmarrjen.


Madje duket se kjo prirje do të jetë e qëndrueshme edhe në periudhë afatmesme (3 vitet e ardhshme) pasi 20 ndërmarrje shprehen se nuk kanë ndër mend të shqyrtojnë rritjen e kontributeve, kundrejt 2 që mund të shqyrtojnë. Arsyeja kryesore për mos rishqyrtimin në rritje të kontributeve rezulton të jetë se ato konsiderohen të mjaftueshme (16 ndërmarrje), ndërsa pjesa tjetër (4) vlerëson se kushton (shih grafikun 17).

**Grafik 17: Arsyet që i bëjnë ndërmarrjet të mos rishqyrtojnë rritjen e kontributeve sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur**



Në ndryshim nga ndërmarrjet që nuk ofrojnë plane pensioni, vërehet që për ndërmarrjet që ofrojnë të tilla, shumica e tyre (16) identifikojnë si faktorë nxitës për rishikimin e kontributeve të pensionit përmirësimin e ofrimit të lehtësisë tatimore dhe ndërgjegjësimin e punonjësve mbi mjaftueshmërinë e pensionit shtetëror. Faktorët e tjerë lidhen me paraqitjen e kërkesës nga ana e punonjësve (6); rritjen e kontributeve nga ana e ndërmarrjeve konkurrencte (4) dhe në fund janë faktorët e besimit në sistemin financiar dhe institucionet e tregut të pensioneve (2). Pra, në atë grup ndërmarrjesh ku ky produkt financiar është më i prekshëm identifikohen më qartazi faktorët afatshkurtër dhe afatgjatë që mbështesin kursimin për pension: faktorët e kostos dhe të ruajtjes së një niveli të arsyeshëm të ardhurash (shih grafik 18).

**Grafik 18: Preferenca për faktorët që mund të nxisin ndërmarrjen të favorizojë rritjen e kontributeve për pensionet sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur**




#### 2.4. Informacion konkludues.

Seksioni D i pyetësorit përmban katër pyetje me anë të të cilave kërkohet të merret informacion mbi nivelin e besimit që perceptojnë ndërmarrjet për institucionet financiare, që janë lojtarë në tregun e pensioneve private, përkatësisht AMF si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës, si dhe të tri shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve. Qëllimi për të njohur këtë perceptim lidhet me faktin që besimi në sektorin financiar luan një rol të rëndësishëm në zgjerimin e qëndrueshmërinë e tij. Në thelb marrëdhëniet financiare janë marrëdhënie besimi dhe pa këtë element nuk mund të zhvillohen tregjet financiare, përfshi edhe tregun e pensioneve private. Në këtë seksion informacioni jepet për 2,074 ndërmarrje.

Nga analiza e rezultateve të vërtetimit të paraqitur në seksionet 2.2 dhe 2.3 më sipër u vërejt se faktorët e besimit në sistemin financiar dhe veçanërisht në institucionet financiare të tregut të pensioneve kanë një ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen apo qëndrimin e punëdhënësve në lidhje me ofertën e planeve të pensionit.

Nga kërkesa e drejtpërdrejtë për të vlerësuar nivelin e besimit të ndërmarrjes për AMF, SHAFP Raiffeisen Invest, SHAFP Sigal-Life Uniqa Group Austria dhe SHAFP SiCRED vërejmë se shkalla e mosnjohjes së tyre është relativisht e konsiderueshme (mbi 1/5 e ndërmarrjeve të vërtetuara). Përsa i takon shoqërive administruese, shkalla e mosnjohjes për to pasqyron strategjinë e marketingut dhe të përfaqesjes që kanë ato kundrejt ndërmarrjeve. Kështu, ka më pak ndërmarrje që nuk kanë dijeni për shoqërinë Sigal Uniqa Group Austria (26.2%), sesa për SiCRED (32.3%) dhe Raiffeisen (33.4%). Ky rezultat përputhet me rezultatet e vërtetimit mbi nivelin e kontakteve që këto shoqëri kishin patur me ndërmarrjet (shih grafikun 19).

**Grafik 19: Shpërndarja e vlerësimit për nivelin e besimit në institucionet financiare të tregut të pensioneve private (në % ndaj ndërmarrjeve gjithsej të vërtetuara)**



Përsa i takon besimit në këto institucione vërehet se në përgjithësi ai është vlerësuar nën nivelin mesatar. Nëse vlerësimin për shkallën e besimit e shprehim me anë të një indeksi besimi, që i merr vlerat nga 0 për kategorinë “nuk kam njohuri për institucionin” në 5 që i korrespondon kategorisë “kam shumë besim te institucioni”, vërejmë që vlerat e indeksit luhaten nga 1.86 në 2.25 (mesatarja 3). Ndërsa diferenca e niveleve të besimit, që llogaritet si diferencë e përqindjeve të ndërmarrjeve, të cilat janë shprehur se kanë besim në intervalet “shumë besim; kam besim; besim mesatar” me ato që shprehen se kanë “pak dhe shumë pak besim”, luhaten nga 18.3 deri në 32.8 pikë përqindjeje. Por në nivelin e besimit duket se ndikon një kombinim më i gjerë faktorësh, sesa thjesht strategjia e marketingut dhe shkalla e njohjes së institucionit (shih tabelën 3).


**Tabelë 3: Indeksi i besimit dhe diferenca e niveleve të besimit\* për shoqëritë administruese**

Shoqëria administruese	Vlera e indeksit	Diferenca e niveleve të besimit (pikë përqindjeje)
Sigal	2.25	32.8
Raiffeisen	1.91	25.2
SiCRED	1.86	18.3

Përsa i takon AMF-së vërehet se numri i ndërmarrjeve që nuk kanë njohuri për këtë institucion është më i vogël sesa për institucionet e tregut të pensioneve (21.1% e ndërmarrjeve të vrojtura) dhe shkalla e besimit për të i përafrohet më shumë nivelit mesatar (2.77). Edhe ky tregues përforcon perceptimin e ndërmarrjeve, të evidentuar gjatë analizës së rezultateve të vrojtimit, të cilat shprehen se kanë më tepër besim në sistemin financiar në tërësi, sesa të SHAFP-së.

Pritshmëritë e ndërmarrjeve janë që, nga ana e AMF-së dhe SHAFP-së, të ketë më shumë dhënie informacioni. Ndërmarrjet konsiderojnë si më të dobishme që informacioni të jetë me shkrim (77.3%). Gjithashtu të rëndësishme konsiderohen edhe format e tjera të ofrimit të informacionit si kryerja e prezantimeve për drejtuesit (64.4%) dhe punonjësit (61.8%). Ndërsa më pak preferohet përdorimi i linjave telefonike të dedikuara të informimit (13%) apo forma të tjera (3.5%) (shih grafikun 20).

**Grafik 20: Preferenca për formën e dhënies së informacionit sipas numrit të ndërmarrjeve që e kanë përzgjedhur**



\* \*

Në përfundim, nga analiza e informacionit të përfutur mbi shkallën e besimit që perceptojnë ndërmarrjet dhe format që ato preferojnë për informim rezulton se në tërësi institucionet e tregut të pensioneve private duhet të shtojnë praninë e tyre në publik. Me këtë nënkuptohet ndjekja e një qasjeje më aktive për kontakte me punëdhënësit e punëmarrësit për të ofruar më shumë informacion për planet e pensionit. Në këtë kontekst shoqëritë administruese është e nevojshme të jenë më proaktive në strategjitë e tyre të marketingut.

Nga ana tjetër, organizimi i fushatave edukuese, duke kombinuar përgatitjen e informacioneve të shkruara në gjuhë të qartë e në formate të thjeshta me kontaktet e drejtpërdrejta nëpërmjet prezantimeve për planet e pensionit, ndihmojnë në rritjen e shkallës së njohurive për këtë produkt.

Së fundi, vetë AMF ka një rol të rëndësishëm si në procesin e edukimit konsumator ashtu edhe në forcimin e besimit në tregjet financiare që mbikëqyr. Këtyre objektivave i shërbehet nëpërmjet:

- Krijimit të strukturave mbikëqyrëse për tregun e pensioneve private që janë të qëndrueshme, të organizuara në mënyrë efektive dhe që mbështeten, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekspertizës së tyre;

- Ndjekjes së një politike licencimi të kujdesshme, sepse tregjet e pensioneve janë mjaft të ndjeshme kundrejt reagimeve të konsumatorëve dhe me ndikim në mirëqenien e popullsisë;
- Përmirësimin të metodologjisë së mbikëqyrjes, në funksion të së cilës është organizuar projekti me BB;
- Rritjes së pranisë në publik dhe vënies së theksit në planet afatmesme të veprimit të elementët e edukimit dhe mbrojtjes konsumatore.

### 3. Përfundimet

Në përfundim të analizës së rezultateve të vrojtimit të kryer me ndërmarrjet mund të themi se:

- Faktorët fiskalë, në veçanti, deri në vitin 2014 kanë frenuar zhvillimin e tregut të pensioneve;
- Klima e biznesit dhe faktorët kostos janë elementë shtesë që kanë kufizuar ndjeshëm kërkesën për produkte të tregut të pensioneve private;
- Shkalla e njohurive për produktet e tregut të pensioneve private është mjaft e kufizuar si nga punëdhënësit edhe nga punëmarrësit;
- Shkalla e besimit në sistemin e financiar rezulton e brishtë.

Zhvillimi i tregut të pensioneve private është e qartë se kërkon që të ndërtohet një ambient i qëndrueshëm makroekonomik për të nxitur kërkesën dhe ofertën për produktet e tregut të pensioneve private. Por kombinimi aktual i rrethanave e bën më të efektshëm që veprimi të përqendrohet në nxitjen e ofertës.

Nga **kahu i kërkesës** në periudhë afatshkurtër korrektimi i trajtimit fiskal të produkteve të pensionit do të krijojë një klimë më të favorshme për të nxitur kërkesën për to.

Gjithashtu, në periudhë afatshkurtër duket e dobishme të ndërmerret një vrojtim tjetër me ndërmarrjet për të studiuar më në hollësi faktorët e kostos. Nga rezultatet e këtij vrojtimi këta faktorë rezultuan të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes së punëdhënësve për të ofruar plane pensioni. Për rrjedhojë, analiza më e detajuar e këtyre faktorëve, veçanërisht nga ana e SHAFP-së, do të ndihmojë në rafinimin strategjive të veprimit për të nxitur kërkesën. Në një kohë të dytë, duhet të studiohet edhe qëndrimi dhe prirja e individëve ndaj produkteve të tregut të pensioneve private, duke vrojtuar drejtpërdrejt individin.

Nga **kahu i ofertës** janë disa veprime që mund të ndërmerren. Së pari, është nevojshme të ketë fushata marketingu më agresive nëpërmjet rritjes së kontakteve me ndërmarrjet. Këto kontakte preferohet të jenë të drejtpërdrejta, kryesisht përmes prezantimeve me punëdhënësit dhe punëmarrësit për të shpjeguar produktet që ofron tregu i pensioneve private. Kjo fushatë është e qartë se duhet të organizohet nga ana e SHAFP-së. Një element pozitiv që ndihmon fushatën e marketingut, dhe që duhet theksuar, është trajtimi i favorshëm fiskal që ofrohet prej janarit të vitit 2015 për këto produkte.

Në varësi të tipareve të ndërmarrjeve të vrojtuar, kjo fushatë mund të synojë fillimisht qarkun e Tiranës, ose pak më gjerë zonën Tiranë-Durrës, që konsiderohen si rajone me peshën kryesore dhe më të qëndrueshme në veprimtarinë ekonomike apo që punësojnë numrin më të madh të punonjësve.

Së dyti nga kahu i ofertës, është e domosdoshme të fillojë fushata edukuese e punëdhënësve dhe punëmarrësve, kryesisht me anë të përdorimit të informacionit të shkruar, por edhe përmes prezantimeve. Në këtë fushatë SHFAP dhe AMF, duke bashkëvepruar, do të duhet të jenë aktorë aktivë. AMF ka nevojë të shtojë praninë në publik dhe të theksojë më tepër në planet afatmesme të veprimit elementët e edukimit dhe të mbrojtjes konsumatore.

Por që masat e marra në periudhë afatshkurtër të kenë rezultate të qëndrueshme, ato kanë nevojë të shoqërohen edhe me ndërhyrje më afatgjata. Kështu, mbetet i nevojshëm reformimi tërësor i sistemit të

pensioneve në vend. Kjo nënkupton zgjerimin me skema alternative pensionesh dhe nxitjen e rritjes së shkallës së kursimit. Në rastin e Shqipërisë dy janë objektivat madhorë të këtij reformimi: (i) *nxitja e vazhdueshme e kolonës së tretë* dhe (ii) *reforma e kolonës së dytë*.

## **REFERENCA**

**AMF:** [http://www.amf.gov.al/bashkepunimi\\_projekt.asp?id=8](http://www.amf.gov.al/bashkepunimi_projekt.asp?id=8)

**INSTAT:** [http://www.instat.gov.al/media/301891/anketa\\_tremujore\\_e\\_forcave\\_te\\_punes\\_t1\\_-\\_2015.pdf](http://www.instat.gov.al/media/301891/anketa_tremujore_e_forcave_te_punes_t1_-_2015.pdf)

“Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve profesionale private”, Raport Vrojtimi, material pune i brendshëm.